

Për ndjekje

- Dr. Juridike

Mustaj B



1777/5

26.10.2018

Nr. 408-409- Regj

Tiranë më 24.10.2018

Lënda : Kërkesë për publikim e ankandit të tretë të pasurisë së paluajtshme

BASHKIA E QYTETIT

MALLAKASTËR

Të nderuar zotërinj!

Pranë shoqërisë përmbarimore "Power & Justice" (P&J) sh.p.k me kërkesë të palës kreditore Raiffeisen-Bank është vënë në ekzekutim titulli Kontrate Kredie Bankare Nr. 4530 rep, Nr. 2222 kol, date 17.10.2011, dhe 2. Kontrate Kredie Bankare Nr. 4531 rep, Nr. 2223 kol, date 17.10.2011, ne ngarkim të pales debitore Shoqëria "EUROPETROL 2005" sh.p.k, për të cilin ju sqarojme se :

Për efekt ekzekutimi të këtij titulli ekzekutiv mbështetur në nenet 568, 577 e vijues të K.Pr.Civil shërbimi përmbarimor ka marrë vendimin për shpalljen me shitje me ankand të pasurisë së paluajtshme të palës debitore Shoqëria "EUROPETROL 2005" sh.p.k, dhe të pales Dorezanese Kujtim Sulaj. Në bazë të nenit 568 të K.Pr.Civile Ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të pales debitore duhet të publikohet edhe pranë Bashkisë së Qytetit, publikimi duhet të kryet pranë institucionit tuaj si institucion pranë të cilit ndodhet pasuria e paluajtshme e pales dorezanese.

Për këto arsye në përputhje me nenin 568 të K.Pr.Civile si dhe nenin 46 të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar, kërkojmë nga ana e institucionit tuaj të mundësoni publikimin në faqën tuaj të WEB-it si dhe në stendën tuaj të njoftimeve për Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme të palës dorezanese.


Duke ju falenderuar për mirëkuptimin mbetemi në pritje të veprimit tuaj.

Me respekt,


Shenim : Bashkelidhur Publikimi i Vendimit të shpalljes së ankandit të tretë të pasurisë së paluajtshme.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

Ilir S. DERVISHAJ



SHOQËSOR PRIVAT



Publikim i Vendimit të Shpalljes
së Ankandit të tretë

Shoqëria përmbarimore "Power & Justice" (P&J) Sh.p.k në zbatim të titullit ekzekutiv Kontrate Kredie Bankare Nr. 4530 rep, Nr. 2222 kol, date 17.10.2011, dhe 2. Kontrate Kredie Bankare Nr. 4531 rep, Nr. 2223 kol, date 17.10.2011, bazuar dhe në nenet 567, 568 e vijues të K.Pr.Civile ka marre vendimin për shpalljen me shitje me ankand të tretë të pasurisë së paluajtshme të palës debitore dhe të pales Dorezanese K Sulaj.

Pasuria që do të shitet në ankand të tretë përbëhet nga :

- Pasuria "Are" me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me sipërfaqe 2500 m2 ndodhur në zonën kadastrale 2869, në fshatin Panahore si dhe sipërfaqe 500 m2 Pasuria "Are" me nr.206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 e ndodhur në zonën kadastrale 2869 në fshatin Panahore ,

Ankandi i sipërfaqes 3.000 m2 fillon me cmim fillestar prej 806.400 leke

- Pasuria "Ndertesë" pjesë e vecuar me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 në fshatin Panahore ,

fillon me cmimin fillestar në masën 252.419 lekë

Çdo ofertues që kërkon të marrë pjesë në ankand duhet të depozitojë në llogarinë e shoqërisë përmbarimore "Power & Justice" (P&J) sh.p.k pranë Raiffeisen Bank sh.p.k shumën prej 10 % të cmimit fillestar si garanci për pjesëmarrjen në ankand si dhe duhet të paraqitet pranë shërbimit përmbarimor për të tërhequr dokumentacionin e ankandit.

Ankandi qëndron i hapur për 30 ditë dhe do të zhvillohet në date 23.11.2018 në orën 15:00, pranë zyrës së shoqërisë përmbarimore të ndodhur në adresën Bulevardi "Gjergj Fishta" Pall. i shoqërisë "Gora" Kulla 1, Kati I, Zyra nr. 5. Tiranë.

Ankandi është ankand progresiv dhe fitues do të shpallet ofertuesi që ofron cmimin më të lartë të sendit. Të gjitha taksat dhe tarifatat që janë të aplikueshme dhe që shërbejnë me qëllim kalimin e pronësisë nga pala debitore tek blerësi, janë në ngarkim të ofertuesit fitues.

Ofertuesit që kërkojnë të inspektojnë pasurinë e shpallur në shitje duhet të komunikojnë me shoqërinë përmbarimore "Power & Justice" sh.p.k nëpërmjet takimit të drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet numrit të tel. 00355 67 20 82 543 ose nëpërmjet e-mailit ilir.dervishaj@yahoo.com si dhe në faqën WEB www.powerjustice-al.com.

Data e shpalljes 22.10.2018



Data e zhvillimit 23.11.2018